



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:235810

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06074820

P.nr.297/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në çështjen penale kundër të pandehurit në cilësinë e personit juridik “...” SH.P.K me seli në Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.1 lidhur me nenin 37 të KPRK-së, dhe të pandehurit në cilësinë e personit përgjegjës, R. C., i akuzuar për shkak të veprës penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1490/22 të datës 26.10.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me dt. 19.06.2024, në prezencën e prokurores së shtetit Ibadete Hamiti, përfaqësuesit me autorizim të të pandehurit në cilësinë e personit juridik,” SH.P.K , av. N. R., dhe të pandehurit R.C me mbrojtësin me autorizim, av.Sh. V., me dt. 24.06.2024 mori dhe shpalli , ndërsa me dt. 23.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.Personi juridik, “....” SH.P.K me seli në Kaçanik, me nr.unik identifikues

2.I pandehuri R.C, me adresë banimi në Prishtinë,-...” pn, i lindur më dt...., nga i ati B... dhe e ëma E..., e gjinisë P..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, menaxher në subjektin afarist “...”SH.P.K, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal: ...

Ne kuptim të nenit 363 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP-së

L I R O H E N N G A A K U Z A

I pandehuri personi juridik “...” SH.P.K.

Sepse në kohë dhe datë të pa vërtetuar personi juridik “...” SH.P.K, përmes personit përgjegjës R.C, me dashje ka kaluar vijën kufitare duke shmangur kontrollin doganor, kështu që me datë 15 Prill 2022, në Fushe të Pajtimit, Komuna Kacanik, saktësisht në subjektin afarist “...” SH.P.K, tek i pandehuri si personi juridik, me numër identifikues ... me rastin e kontrollit detal të dokumentacionit dhe mallit nga ana e Doganës së Kosovës, është konstatuar se një pjesë e mallit në sasi prej 49.474.99 kg. Pelhure e endur – metrazhe, nuk ka import apo blerje të brendshme, në mënyrë që të dokumentohet prejardhja e mallit, me ç’rast i shkakton dëm material Doganës së Kosovës në vlerë prej 29.486,50 €.

Me çka kishte për të kryer veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par. 1 lidhur me nenin 37 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.

I pandehuri R.C.

Sepse në kohë dhe datë të pa vërtetuar, në cilësi të personit përgjegjës të personit juridik “...” SH.P.K me dashje ka kaluar vijën kufitare duke shmangur kontrollin doganor, kështu që me datë

15 Prill 2022 në Fushe të Pajtimit, Komuna Kacanik, saktësisht në subjektin afarist “...” SH.P.K, në cilësinë e personit përgjegjës të personit juridik, me rastin e kontrollit detal të dokumentacionit dhe mallit nga ana e Doganës së Kosovës, është konstatuar se një pjesë e mallit në sasi prej 49.474.99 kg. pëlhurë e endur –metrazhe, nuk ka import apo blerje te brendshme, në mënyrë që të dokumentohet prejardhja e mallit .

Me çka kishte për të kryer veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngrit aktakuzën PP.nr. 1490/22 të dt. 26.10.2022, kundër të pandehurit në cilësinë e personit juridik “...” SH.P.K me seli në Kaçanik, dhe të pandehurit në cilësinë e personit përgjegjës, R.C, për veprën penale, Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par.3 të KPRK-së 06/L-074.

Në bazë të kësaj aktakuze, Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 09.03.2023 , me të cilin rast pas prezentimit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, përfaqësuesi i të pandehurit dhe i i pandehuri në cilësinë e personit përgjegjës, janë deklaruar jo fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohen.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur në këtë çështje penale, prokurorja e shtetit Ibadete Hamiti ka deklaruar se, provat e shqyrtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor tregojnë se gjendja faktike e paraqitur si në aktakuzë ka ndryshuar, prandaj konfor nenit 348 par.1 të KPP-së bën ndryshimin e dispozitivit dhe kualifikimit juridik të aktakuzës, si në vijim:

I pandehuri në cilësinë e personit juridik “...” SH.P.K

I . Në kohë dhe datë të pa vërtetuar personi juridik “...” Sh.P.K, përmes personit përgjegjës R.C, me dashje ka kaluar vijën kufitare duke shmangur kontrollin doganor, kështu që me datë 15 Prill

2022, në Fushë të Pajtimit, Komuna Kacanik, saktësisht në subjektin afarist “...”, SH.P. K, tek i pandehuri si person juridik me numër identifikues ..., me rastin e kontrollit detal të dokumentacionit dhe mallit nga ana e Doganës së Kosovës, është konstatuar se një pjesë –sasi 49.474.99 kg, ëelhurë e endur – metrazhë ,nuk ka import apo blerje të brendshme, në mënyrë që të dokumentohet prejardhja e mallit, me ç’rast i shkakton dëm material Doganës së Kosovës ne vlerë prej 29.486,50 €.

Me të cilën ka kryer vepren penale, Kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 1 lidhur me nenin 37 te Kodit Penal te Republikës së Kosovës Nr. .06/L-074.

I pandehuri R. C. :

II. Në kohë dhe datë të pa vërtetuar, në cilësi të personit përgjegjës të personit juridik “...” SH.P.K , me dashje ka kaluar vijën kufitare duke shmangur kontrollin doganor, kështu që me datë 15 Prill 2022, në Fushe të Pajtimit, Komuna e Kacanikut , saktësisht në subjektin afarist “...” SH.P.K , në cilësinë e personit përgjegjës të personit juridik, me rastin e kontrollit detal të dokumentacionit dhe mallit nga ana e Doganës së Kosovës, është konstatuar se një pjesë – sasi 49.474.99 kg , pëlhure e endur –metrazhe ,nuk ka import apo blerje të brendshme, në mënyrë që të dokumentohet preardhja e mallit .

Me të cilën ka kryer vepren penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par. 1 te Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. .06/L-074.

Në fjalën e saj përfundimtare ka theksuar se, pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre veq e veq dhe të gjitha së bashku, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të pandehurit: personit juridik “...” SH.P.K. dhe personi përgjegjës – i pandehuri R.C, kanë kryer veprat penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 te Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës .

Se të pandehurit kanë kryer veprat penale ashtu siq u vihet në barrë me aktakuzë, gjatë shqyrtimit gjyqësor u vertetua nga dëshmitë e dëshmitarëve L. Xh., L. I.dhe B. Sh., dëshmia e ekspertes M. B., provat materiale të propozuara në aktakuzë dhe ekspertizës financiare, me numër 01/2024 të datës 23.02.2024.

Është fakt i pakontestueshëm së të pandehurit me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të ndryshimit të aktakuzës, të datës 19.06.2024 .

Gjendja faktike dhe përshkrimi si më lartë, u vërtetua nga dëshmia e dëshmitarit – zyrtarit doganor L. Gj., e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, i kujtohet se me datë 15.04.2022 kishin realizuar, sipas mandatit të Doganës së Kosovës një kontrollë në subjektin “ ...” SH.P.K në Kacanik, të njejtit i kishin njoftuar se do të kryejnë një kontrollë, në subjektin “....” SH. P. K në Kacanik, të njejtit i kishin njoftuar se do të kryejne një kontrollë, e më pas zyrtarët kompetent kanë filluar numërimin e mallrave që janë ndodhur në deponë e tyre, gjithmonë në prezencë të personelit të autorizuar nga menaxhmenti i kompanisë, ku gjatë kontrollit është hasur një sasi e mallit, për të cilin mall nuk ka patur dokumentacion, nuk e mban mend nëse kjo kompani është e liruar nga detyrimet Doganore pa e parë dokumentacionin dhe shton se gjatë kontrollit është hasur pa dokumentacion përkatës, sipas përshkrimit të raportit të SKPI-së .

Dëshmitari Be. Sh., në dëshminë e tij të paraqitur në shqyrtim gjyqësor ka dëshmuar se ushtron pozitën e udheheqesit të njësitit në sektorin antikntrabandë në Doganën e Kosovës dhe sa i përket rastit konkret ka dëshmuar se kanë qenë në kontrollë së bashku me kolegun e tij Nexhmedin Mirena dhe kolegë nga dy sektorë tjerë të hetimeve dhe kontrollit pas importit ,ku në bazë të dokumentacionit, subjekti “....” SH.P.K i cili merret me importimin e penjve dhe përpunimin e tyre në fabrikë për krijimin e produktit pëlhurë, ku gjatë kontrollit kanë bërë numërimin e gjendjes faktike të mallit, i cili ka qenë në depo dhe pas përfundimit të kontrollit ka qenë një sasi mbi 49.000 kg, pa mbulesë të dokumentacionit dhe bëhet fjalë për mallin astar, pra mallin në fjalë nga personat përgjegjës të kësaj kompanie nuk është ofruar dokumentacion as për blerjen e brendshme të mallit as për blerjen e brendshme, duke shtuar se mallin e kanë sekuestruar në bashkëpunim me sektorin e hetimeve dhe kontrollit pas importit, duke përpiluar raport, të cilin e ka dërguar në sektorin e hetimeve .

Dëshmitarja L. I, në dëshminë e saj të paraqitur në fazën e hetimeve dhe në shqyrtim gjyqësor, ka dëshmuar se ushtron pozitën e udheheqesës së Njesitit SKPI-Dogana e Kosovës dhe sa i përket rastit konkret ka dëshmuar se me date 14.04.2022 me sektor të tjerë brenda Doganës së Kosoves dhe atë Sektorin Antikntrabandë dhe Hetues, kane ushtruar kontrollë dokumentare dhe të mallit në kompaninë “....” fillimisht duke kërkuar nga përfaqesuesi i kompanisë në fjalë që të paraqet listen e stokut dhe me pas kane numëruar mallin ,sasi e mallit nuk është përputh me listen e stokut, e cila është prezantuar nga kompania në hapësirat e kompanisë, është konstatuar një sasi

e konsiderueshme e pëlhares së endur –metrazh për të cilin kanë kërkuar dokumente shtesë, si fatura të brendshme, nëse pala është furnizuar brenda Kosovës me atë mall, por pala nuk ka dëshmuar me asnjë dokument për blerjen e mallit brenda dhe as nuk ka prezantuar dokument doganor lidhur me zhdoganimin e kësaj pjese të mallit , ku pas kësaj është konstatuar që për 49.474 kg, nuk ka mbulesë dokumentare dhe si rrjedhojë është ndaluar nga ekipet e antikntrabandës , e po ashtu në ambalazhin e këtyre materiale dhe në fillim te materialeve ka pasur mbishkrime në gjuhën kineze për peshën, sasinë, llojin e mallit që kanë qenë dyshimet që ai mall nuk është prodhuar aty. Duke shtuar në fund se gjatë ditës se kontrollit makineritë nuk ka punuar për prodhim dhe ky mall është dashur që të përputhet me listën e stokut, të cilin vet kompania e ka prezantuar, prandaj ky mall ka qenë jashtë listës së stokut dhe ky mall ndryshe quhet si mall pa dokumente .

Deshmitarja M.B, në deshminë e saj të paraqitur në shqyrtim gjyqësor, ka dëshmuar se ushtron pozitën e ekspertës financiare që nga viti 2012 dhe është e licencuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe se mbetet në tërësi pranë ekspertizës financiare të bërë , duke sqaruar se në mesin e katër detyrave sipas udhërësës, kishte patur për detyrë që nëse gjatë punës së saj has në ndonjë çështje tjetër që ndikon në zgjidhjen e çështjes të konstatohet , ashtu që meqë në këtë rast kishin të bëjnë me mallra të konfiskuara dhe pa dokumentacion ashtu siq është përshkruar në ekspertizë, ka konstatuar edhe gjobat për mallrat pa dokumentacion, dhe e cila është 30 % e vlerës së mallit të konfiskuar ,e që kjo nenkupton gjobë dhe jo shmangie, e po ashtu ka mbetur prane faqes se 10 pika 3 ku ka konstatuar demin te cilin i është shkaktuar Doganës së Kosovës.

Se në të vërtete i pandehuri ka kryer veprën penale si në dispozitiv të ktakuzës vertetohet edhe nga provat materiale të cilat jane administruar edhe në shqyrtim gjyqësor si në vijim: raporti i Doganës së Kosovës i dates 15.04.2022, raporti informativ i datës 19.04.2022, me anë të së cilit është konstatuar se sasia e mallit metrazhës (astafit apo pëlhurës) për të cilin pala nuk ka ofruar dokumente dhe ekipi i Anti kontrabandës së Doganës së Kosovës, ka konstatuar sasinë e pëlhurës së ndaluar 49.7474.00 kg. neto,sipas dosjes se vlerës (metodë e vlerësimit në Doganë nr. ID.1114),emërtimi (Astar apo pëlhure), ky mall vleresohet 2 euro per kg., ku vlere totale e mallit të sekuestruar është 98948.00 € , ndërsa vlere e detyrimeve doganore eshte 29, 486.50 € .

Mendimi për përcaktimin e vlerës, me numer 263 të datës 19.04.2022, me anë të së ciles ka trajtuar lëndën dhe ka shprehur mendim se malli ka vlerën pëlhurë /metrazhe (astar) , sasia 49474 kg, ku vlere pa taksa doganore 98,948.00 euro, taksat 10% =9,894.80 dhe TVSH 18=19,591.70

euro, e cila metodë është bërë me metodën e 6- të vlerësimit të mallit , neni 335 i Kodit Doganor dhe Akcizave .

Listë distribuimi i Doganeë së Kosovës, të datës 19.04.2022 me anë të së cilës vërtetohet se Dogana e Kosovës, ka realizuar një kontroll në subjektin “...” Shpk, në Kacanik, me numër identifikues ... me pronar S.I, duke sekuestruar mallin e gjetur në depo, i cili nuk posedon dokumentacionin përkatës .

Vërtetimi mbi konfiskimin e mallrave, i datës 15.04.2024, me të cilin vërtetohet se AK-5 së bashku me Sektorin e Hetimeve dhe te kontrollit pas importit , kane ushtruar kontroll tek subjekti “...” sh.p.k, me adrese ne Fushë të Pajtimit në Kacanik, me numer.., ku gjatë kontrollimit kanë hasur në parregullsi, ku nje pjesë e pëlhures (astar apo pëlhurë) , me qrast sasia prej 49474.00 kg. Neto nuk kishte importe apo blerje te brendshme që dëshmonte preardhjen e mallit .

Ekspertiza financiare me numër 01/24 e dt. 23.02.2024 nga ana e ekspertes financiare te licencuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës M.B ,e cila ka konstatuar se sasia totale e mallit Pëlhere e endur –metrazhe e gjetur pa dokumentacion, fatura apo DUD/a si dhe e pa regjistruar në listen e stokut, të datës 28.02.2022 kap vleren prej 494.00 kg. Dhe mallrat e konfiskuar “Pëlhurë e endur – metrazhe “ jane pa dokumentacion përkatës. Po ashtu ne kete ekspertize ka konstatuar se objekt kontrole kanë qenë mallrat e importuara – pëlhere të endura prej fibrave kryesore artificiale ne sasi prej 49.474.99 kg. Mallra ne fjalet ishin pa dokumentacion që dëshmon preardhjen e mallit dhe gjoba për mallra pa dokumentacion , kap vleren prej 30 % se mallit ,e cila eshte 29.684.40 Euro .

I pandehuri R.C para Prokurorit te Shtetit si dhe ne shqyrtim gjyqësor, ka mohuar kryerjen e vepres penale, duke deklaruar se ushtron poziten e menaxherit të kompanise “...” , dhe se ne kohen kur kanë ardhur zyrtaret doganorë, ka qene prezent gjatë tërë kohës deri sa është realizuar kontrolla dhe se është e vërtetë që nuk kanë poseduar dokumentacion, me arsye se pas një kontrole të gjitha DUD-ave apo dokumenteve unike doganore me të cilat dëshmohet prejardhja e mallit, kishte vërejtur se në tre DUD-a , me numer R.../2022, R.../2022 dhe R.../2022, dhe pas kontrollës është vërejtur se keta tre DUD-a , ka gabime teknike që janë ngatërruar me fije njëshe për prodhimin e tekstit, me pëlhura të endura prej fibrave kryesore artificiale dhe pas kontrollës është hasur ky gabim që ka nisur qysh prej furnizuesit nga Kina , dhe pasi kishte vërejtur keto gabime teknike ka kontaktuar me zyrtaret doganor në Prishtine ,të cilëve është

munduar t'ia sqarojë problemin për këta tre DUD-a , ku nga doganierët ka marrë përgjigje se malli është konfiskuar, ndërsa meqë është vlera e madhe, do të merret Prokuroria ,por që nuk ka bërë kërkesë me shkrim lidhur me këto lëshime, Me tej gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kanë kontaktuar me doganën në shtetin e Kinës ,por qe nuk e kanë marrë parasysht kërkesën, ngase kishte kaluar një kohë e gjatë dhe ajo është kompani multi milionere dhe për këtë arsye nuk kane mundur të marrin një përgjigje definitive .

Prokurori i shtetit vlereson se sa i perket mbrojtjes se te pandehurit, kjo mbrojtje nuk mbeshtetet ne provat personale dhe materiale të elaboruara me lartë dhe se ky mohim është bërë vetëm sa për t'iu shmangur përgjegjësisë penale.

Prandaj mbi bazen e te lartecekurave, Prokurori i shtetit konsideron se, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të KPRK-së, andaj i propozon gjykatës që të pandehurit e lartëcekur t'i gjejë dhe shpall fajtorë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, ndërsa me rastin e matjes dhe përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merren parasysht të gjitha rrethanat, ashtu që mbi bazën e të lartecekurave të njëjtit t'i shqiptojë një sanksion penal të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, i cili do t'i përgjigjet të gjitha rrethanve të kryerjes së veprës penale dhe me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit .

Në kuptim të nenit 311 par. 6 të Kodit Penal të Republikës se Kosovës, i propozon gjykatës që të konfiskojë në mënyrë të përhershme mallrat-pëlhure e endur metrazh –astar në sasine prej 49,474.00 kg, të sekuestruar sipas urdheresës së Gjykatës të dates 20.04.2022.

Mbrojtësi i personit juridik “.... “ SH.P.K, av. N. R. në fjalën e tij përfundimtare , ka theksuar se, sa i përket ndryshimit të aktakuzës nga ana e Prokurorisë i njëjti ndryshim është bërë në kundërshtim me nenin 348 të KPPRK-së meqenëse shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar me administrimin e provave, prandaj ky ndryshim nuk ka asnjë baze ligjore. Sa i përket rikualifikimit te veprës penale, thekson se, vepra penale e Kontrabandimit të mallrave konsumohet ne rastin kur një person fizik apo juridik gjatë tentimit të kalimit të kufirit me mallra të pa deklaruar tenton që t'a shmang mallin t'a bart ose t'a fut nga njeri shtet ne shtetin tjetër , dhe i njëjti mall vërehet apo zihet nga autoritetet doganore, e që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë fare me kontrabandimin e mallit, meqenëse i njëjti mall është bartur pa asnjë problem tek biznesi-personi juridik, SHPK. Prandaj në rastin konkret, Kontrabandimi i mallit konsumohet nëse i

njëjti është prezent te personi juridik, decidivisht gjatë kalimit të vijës kufitare. Andaj ka kërkuar nga gjykata që konfor nenit 363 par. 1 pika 1.3 të KPRK-së, t'a lirojë të pandehurin personin juridik SHPK nga përgjegjësia penale e cila i vihet në barrë sipas aktit akuzues ,me arsyetimet të cilat i kanë elaboruar gjatë seancave gjyqësore e po ashtu edhe me këtë fjalë përfundimtare.

Mbrojtësi i te pandehurit në cilësinë e personit përgjegjës av. Sh. V., deklaroi se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit av.N. R.

I pandehuri R.C, poashtu e mbështet mbështet fjalën e mbrojtësit te tij, dhe shton se nuk e ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet. Në mbrojtjen e tij i njëjti, duke përmendur sfidat e paraqitura për hapjen e këtij biznesi, dhe duke potencuar edhe mungesën e përvojës së të punësuarve në përgaditjen e dokumenteve të importit, i ka arsyetuar edhe gabimet në dokumentet e importit, ku sipas tij janë paraqitur gabime në 3 nga 115 imoportet totale, dhe edhe pse nuk kishte ndryshim në peshën totale të produkteve të importuara, ndryshimet midis produkteve të deklaruara u injoruan, dhe kjo rezultoi në fije të tepërta dhe më pak pëlhurë , dhe duke mos patur mundësi që brenda afatit të dhënë nga Dogana që të arsyetojmë këtë mospërputhje, sekuestrohet malli duke e dërguar në deponë doganore për ruajtje. I njëjti, poashtu thekson se në ndërkohë u ishte mundësuar nga Dogana një takim, në të cilin u sqaruar gabimet, mirë meqë, sipas tyre, pasi që vlera e mallarave ishte mbi 5000 €, çështja ishte dërguar në Prokurori. I njëjti poashtu ka theksuar se kishin tentuar që këtë çështje t'a rregullojnë me vendin e origjinës së mallit, mirëpo nuk kanë marrë përgjigje nga ana e tyre. Prandaj, duke u bazuar në të lartëcekurat, i njëjti ka kërkuar që të lirohet nga akuza në rastin konkret.

Meqë i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor me prezantimin dhe administrimin e provave te propozuara, duke dëgjuar dëshmitarët: L. Gj., B. Sh.dhe L. I., si dhe leximin e raportit të Doganës së Kosovës të dt.15.04.2022, raportin informativ të Doganës së Kosovës, të dt.19.04.2022, mendimin për përcaktimin e vlerës me nr.263/19 të dt.19.04.2022, listë distribuimin nga Dogana e Kosovës, të dt.19.04.2022, vërtetimin mbi ndaljen –konfiskimin e mallrave të dt.15.04.2022, urdhëresa për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e dt.20.04.2022, deklarata e S. I., e dhënë në Doganën e Kosovës me dt.30.05.2022 dhe deklarata e të pandehurit R.C, e dhënë në Prokurori me dt.21.10.2022,

Dëshmitari L. Gj, në fjalën e tij ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, me dt.15.04.2022, duke qenë udhëheqës i Njësitit të Hetimeve në Doganën e Kosovës, ka realizuar një kontrollë në subjektin afarist SHPK në Kacanik, me të cilin rast zyrtarët e hetimeve kanë kontaktuar personat përgjegjës në lokacionin e kësaj kompanie, janë informuar se do të zhvillojnë një kontrollë sipas mandatit të Doganës, dhe më pas zyrtarët kompetent kanë filluar numërimin e mallrave që janë ndodhur në depotë e tyre, gjithmonë në prezencë edhe të personelit të autorizuar nga menaxhmenti i kësaj kompanie. Aq sa mban në mend pas numërimit zyrtarët e Doganës, bashkë me zyrtarët përgjegjës nga sektori i kontrollit pas importues, kanë analizuar dokumentacionin përcjellës, për këtë mall, dhe se prezent në këtë kontrollë kanë qenë të gjithë zyrtarët e Doganës, emrat e të cilëve janë cekur në Raportin informues të dt.19.04.2022, derisa kallëzimin penal e ka përpiluar dëshmitari, duke u bazuar në provat e bashkangjitura në kallzim penal. I njëjti në fjalën e tij ka theksuar se me rastin e kontrollit të realizuar në kompaninë në fjalë, është hasur një sasi e mallit për të cilin mall nuk ka patur dokumentacion. Nuk mban mend dhe pa patur dokumentacionin e duhur, nuk e di nëse e njëjta-pra kompania në fjalë ka qenë ose jo e liruar nga detyrimet doganore. I njëjti ka sqaruar se është sektori i kontrollit pas importues apo SKPI, ka përpiluar raportin informativ të dt. 19.04.2022, i cili i dërgohet njësitit të hetimeve, dhe ky i fundit pastaj kërkon nga sektori i vlerësimit të vlerës që të bëhet vlerësimi i mallit, dhe të njëjtit përcaktojnë mallin dhe taksat për mallin në fjalë. Dhe bazuar në këto raporte, ka përshkruar se cila pjesë e mallit ka qenë pa dokumentacion, dhe shton se nga kompania në fjalë është kërkuar që në afat sa më të shpejtë që të jetë e mundur i është dhënë afat për sigurimin e dokumentacionit për mallin që ka qenë pa dokumente në mënyrë që të sqarohet edhe ajo sasi dhe nuk e di se sa ka qenë afati, por e di që i është thënë që dokumentet të sigurohen sa ma shpejtë të jetë e mundur. Sa i përket vendimit nr.118/2021, thot se i njëjti ka të bëjë me mallrat të cilë dekalrohen paraprakisht, derisa në rastin konkret, nuk ka mundur që të dihet se nga ka ardh malli në fjalë, meqë nuk ka patur fare dokumentacion I njëjti poashtu ka theksuar se ekziston mundësia e përmirësimit të gabimit teknik në DUD, dhe përmirësimi behet kur subjekti që i sjell ato mallra, ofron dëshmi se me të vërtet ka ndodhur një gabim teknik, sepse DUD-i duhet gjithmonë të jetë në përputhje me mallin, meqë malli përmes këtij dokumenti deklarohet, dhe derisa kompania nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për prejardhjen e mallit, SKPI ka raportuar tek njësiti i hetimeve se kompania në fjalë ka mall pa dokumentacion.

Dëshmitari B. Sh, në fjalën e tij ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, me dt.15.04.2022 është realizur kontrollë në kompaninë në fjalë, në prezencë të personave përgjegjës të saj, dhe në

bashkëpunim me sektorin e kontrollit pas importues të Doganës kanë bërë numërimin e gjendjes faktike të mallit i cili ka qenë në depo, dhe pas kontrollit ka rezultuar se te subjekti në fjalë ka qenë një sai e mallit prej mbi 49.000 pa mbulesë të dokumentacionit. Meqë nga personat përgjegjës të kësaj kompanie nuk është ofruar dokumentacion as për blerje të brendshme të mallit por as për import, gjegjësisht as dokument unik doganor dhe as fatura të blerjes në tregun e brendshëm, për shkak të kësaj parregullsie, malli është sekuestruar dh për këtë është përpiluar raport i cili është dërguar në sektorin e hetimeve në Doganë.

Dëshmitarja L. I., në fjalën e saj në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, lidhur me rastin konkret ka përpiluar raportin e dt.19.04.2022, dhe ate pasi që me dt.14.04.2022 kishin bërë kontrolle dokumentare dhe të mallit në kompaninë Me rastin e kontrollit, fillimisht kishin kërkuar nga përfaqësuesi i kompanisë që të paraqesë listën e stokut dhe kanë numëruar mallin, me të cilin rast sasia e mallit nuk është përputh me listën e stokut e cila është prezentuar nga kompania, kështu që gjatë kontrollit në kompaninë në fjalë është konstatuar një sasi e konsiderueshme e pëhurës së endur metrazhe, për të cilën edhe kanë kërkuar dokumente shtesë si faktura të brendshme ose dokumente të importit, këto të fundit nuk janë siguruar nga kompania, prandaj edhe është konstatuar se kjo pjesë e mallit prej 49,474 kg, është pa mbulesë dokumentare dhe si rrjedhojë malli është ndaluar nga ekipi i antikontabandës. E njëjta poashtu ka shtuar se në ambalazhin e këtyre materialeve dhe në fillim të materialit ka patur mbishkrime në gjuhën kineze lidhur me peshën, sasinë dhe llojin e mallit dhe dyshimi i ekipit kontrollues ka qenë se malli në fjalë nuk është prodhuar në fabrikë.

Ekspertja finaciare M.B në fjalën e saj gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se si ekonomiste me profesion, është e licencuar si eksperte finansiare që nga viti 2012. Për rastin konkret tregon se pasi që ka pranuar urdhëresën e kësaj gjykate, bashkë me të gjitha shkresat e lëndës në origjinal, ka siguruar dokumentacionin shtesë për konstatim të gjendjes, për çka të gjitha veprimet janë janë përshkruar edhe në ekspertizë. E njëjta, në fjalën e saj qëndron pranë mendimit dhe konstatimit të dhënë si në ekspertizën me shkrim, dhe sqaron se meqë në mesin e katër detyrave që kishte në bazë të urdhëresës, kishte edhe një detyrë tjetër që, nëse gjatë punës së saj, has apo vëren edhe ndonjë çështje tjetër që ndikon në zgjidhjen e çështjes, i duhej që t'a konstatonte, e meqë rasti konkret kishte të bëjë me mallra të konfiskuar dhe pa dokumentacion, ashtu siq e ka përshkruar edhe në ekspertizë, ka kontaktuar edhe gjobat që parashihen për mallrat pa dokumentacion dhe e cila është 30 % e vlerës së mallit të konfiskuar . dhe kjo nënkupton gjobë dhe jo shmangie, ndërsa sa i përket dëmit të Doganës, qëndron pranë konstatimit si në

faqen 10 pika 3 të ekspertizës, dhe shton se për rastin konkret është takuar edhe me zyrtarët e Doganës por të njëjtit nuk i kanë ofruar dokumentacion, me arsyetimin se të gjitha dokumentet janë në shkresat e lëndës. E njëjta poashtu sqaron se, bazuar në dokumentacionin e siguruar në këtë çështje, përfshirë edhe dokumentacionin shtesë nga kompania, malli i sekuestruar nuk ka qenë i mbuluar me dokumentacion.

Ne fazën e adminstrimit të provave materiale janë lexuar: raporti i Doganës se Kosovës i datës 15.04.2022, raporti informativ i Doganës së Kosovës i datës 19.04.2022 ,mendimi për përcaktimin e vlerës me nr. 263 dt. 19.04.2022, listë distribuimi e Doganës së Kosovës e dt. 19.04.2022, vërtetimi mbi ndaljen –konfiskimin e mallrave i dt. 15.04.2022, urdhëresa për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e dt. 20.04.2022, deklarata e të pandehurit S.I e dhënë në Doganën e Kosovës me dt. 30.05.2022 dhe deklarata e të pandehurit R.C e dhënë në Prokurori me dt. 21.10.2022.

Nga dëshmia e dëshmitarit L.Gj gjykata konstatoi se pas përfundimit të kontrollit inspektues në kompaninë Shpk, me dt.15.04.2022, së bashku me zyrtarët nga ekipi i SKPI-së dhe Antikontrabandës, në prezencën e personave përgjegjës të kompanisë, është hasur një sasi e mallit për të cilin mall nuk ka patur dokumentacion, për çka edhe SKPI, ka përpiluar raportin informativ të dt. 19.04.2022, i cili i është dërguar njësitet të hetimeve, dhe ky i fundit pastaj, pasi ka kërkuar nga sektori i vlerësimit të vlerës që të bëhet vlerësimi i mallit, dhe meqë kompania në fjalë, nuk ka arritur që të sigurojë dokumentacion për mallin që ka qenë pa dokumente, malli pa dokumentacion është sekuestruar dhe lidhur me rastin konkret është ngrit edhe kallëzimi penal.

Fakte të njëjta janë vërtetuar edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve B. Sh., zyrtar doganor nga Njësiti Antikontrabandë dhe dëshmia e dëshmitares L. I, zyrtare doganore nga Njësiti i Kontrollit Pas Importues apo SKPI, të cilët poashtu vërtetuan se me rastin e kontrollit të mallit dhe dokumenteve në kompaninë Shpk, një pjesë e mallit prej 49,474.00kg, ka qenë pa dokumentacion apo siq thuhet nga dëshmitarët pa mbulesë dokumentare, prandaj edhe malli është sekuestruar.

Gjykata u fali besimin dëshmive të këtyre dëshmitarëve, meqë dëshmia e tyre gjen mbështetje edhe në ekspertizën financiare me nr.01/2024 të dt.23.02.2024 të ekspertes financiare M. B, e cila në faqen e tetë të kësaj ekspertize ka konstatuar se malli i sekuestruar “Pëlhurë e endur –

metrazhe” në sasi prej 49,474.00 kg, neto, është mall që është i liruar nga pagesat e detyrueshme të tarifave doganore ose tarifave akcizore (referuar vendimeve ILP-Ankes I për qëllime të TVSH-së dhe ILP-Aneks II për qëllime të taksës doganore) por që nuk ka qenë i mbuluar me dokumentacion. Deklaratat e dëshmitarëve poashtu gjejnë mbështetje edhe në provat materiale të administruara por edhe në vetë mbrojtjen e të pandehurve, të cilët pohojnë se për mallin në fjalë nuk kanë mundur që të ofrojnë dokumentacion për Doganën e Kosovës, mirëpo janë arsyetuar se kjo ka ndodhur për shkak të gabimeve teknike në DUD-at me nr: 7849,17354 dhe 80790., edhe pse kjo e fundit veq është sqaruar nga ekspertja financiare në mendimin dhe konstatimin e saj me shkrim, se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë gabim teknik, pavarësisht sqarimeve dhe fakteve të parashtruara nga subjekti “....”Shpk.

Megjithatë përmes këtyre dëshmime, gjykata nuk arriti që të vërtetojë se në veprimet e të pandehurve ka elemente të veprës penale për të cilën akuzohen, sepse nga këto dëshmi përveq që vërtetohet se malli në fjalë ka qenë pa dokumentacion për import apo fatura të brendshme, nuk vërtetohet se malli në fjalë është kontrabanduar, gjegjësisht se i njëjti ka kaluar vijën kufitare duke i’u shmangur kontrollit doganor.

Se në subjektin “....”Shpk”është realizuar kontrolli inspektues me dt.15.04.2022 dhe se pas këtij kontrolli është gjetur mall “Pëlhurë e endur –metrazhe” në sasi prej 49,474.00 kg, neto, pa dokumentacion, e cila pastaj është sekuestruar, u vërtetua edhe nga provat materiale si: Raporti i Doganës i dt.15.04.2022, Raporti Informativ i Doganës së Kosovës i dt.19.04.2022, Mendimi për Përcaktimin e Vlerës me nr.263 i dt.19.04.2022, Lista e Distribuimit, vërtetimi mbi ndaljen –konfiskimin e mallrave i dt. 15.04.2022, urdhëresa për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e dt. 20.04.2022, dhe pjesërisht edhe nga deklarata e të pandehurit S.Ie dhënë në Doganën e Kosovës me dt. 30.05.2022 dhe deklarata e të pandehurit R.C e dhënë në Prokurori me dt. 21.10.2022.

Prandaj gjykata u fali besimin këtyre provave materiale, meqë të njëjtat përveq që gjejnë mbështetje në njëra tjetrën, në dëshmitë e dëshmitarëve por edhe në ekspertizën financiare, të ekspertes Financiare të ekspertes M.B e cila përveq në formën me shkrim edhe përmes sqarimeve të saj të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, qëndroi pranë konstatimit se malli në fjalë ka qenë i pa mbuluar me dokumentacion, dhe se nuk ka patur asnjë gabim teknik në DUD-at me nr. ... dhe ..., ashtu siq ka pretenduar mbrojtja.

Për më tepër e njëjta, ekspertja financiare, përveq që ka konstatuar se malli i sekuestruar “Pëlhurë e endur –metrazhe” në sasi prej 49,474.00 kg, neto, është mall që është i liruar nga pagesat e detyrueshme të tarifave doganore ose tarifave akcizore (referuar vendimeve ILP-Ankes I për qëllime të TVSH-së dhe ILP-Aneks II për qëllime të taksës doganore) dhe rrjedhimisht në rastin konkret, nuk ka dëm të shkaktuar lidhur me rastin në fjalë, ka konstatuar dhe faktin se referuar Ligjit Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore në fuqi, neni 109 –Gjoha për mallrat pa dokumentacion, par.1 parasheh që “Kur një person i angazhuar në aktivitet ekonomik posedon mallra pa dokumentacion për blerjen e tyre, ai i nështrohet gjobës prej 30% të vlerës së tregut të atyre mallrave.

Gjykata i fali besimin edhe mendimit dhe konstatimit të ekspertes financiare M. B., meqë mendimi dhe konstatimi i saj gjen mbështetje, përveq në dëshminë e dëshmitarëve dhe në provat tjera materiale, poashtu edhe në vendimet ILP-Ankes I për qëllime të TVSH-së dhe ILP-Aneks II për qëllime të taksës doganore, por edhe në Ligjin Nr.04/L-223 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit 03/L-222për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-102 si dhe Ligjin Nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore në fuqi.

Megjithatë, sikurse edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve, as nga provat materiale të administruara por edhe nga ndëgjimi i ekspertes financiare, gjykata nuk arriti që të vërtetojë se të pandehurit, kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, përveq faktit që malli në fjalë ka qenë pa dokumentacion.

Gjykata poashtu vlerësoi edhe mbrojtjen e të pandehurve, se në rastin konkret, për shkak të mungesës së përvojës së mjaftueshme të të punësuarve, ka ndodhur gabim teknik në dokumente unike doganore, e që rrjedhimisht sipas tyre i bie që malli në fjalë është importuar nga jashtë, megjithatë një mbrojtje të tillë gjykata nuk mund që t’i fal besimin meqë ishte ekspertja financiare M. B. e cila në mendimin dhe konstatimin e saj me shkrim por edhe para gjykatës ka sqaruar se, nuk ka patur asnjë gabim teknik në DUD-at me nr. .. dhe ..., pavarësisht sqarimeve dhe fakteve të parashtruara nga subjekti “....”Shpk.

Nga administrimi dhe analizimi i të gjitha këtyre provave në rastin konkret, për gjykatën nuk është kontestuese se malli i sekuestruar “Pëlhurë e endur –metrazhe” në sasi prej 49,474.00 kg, neto, është mall që është i liruar nga pagesat e detyrueshme të tarifave doganore ose tarifave

akcizore (referuar vendimeve ILP-Ankes I për qëllime të TVSH-së dhe ILP-Aneks II për qëllime të taksës doganore) dhe është mall i pa mbuluar me dokumentacion, pra nuk ka mbulesë dokumentare as me importe dhe as me fatura të brendshme, meqë kjo tashmë është vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, të cilave gjykata edhe u fali besimin, por që me këto prova gjykata nuk arriti që të vërtetojë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, sipas aktakuzës së ndryshuar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe konfor nenit 348 par.1 të KPRK-së.

Bazuar në po të njëjta prova, Prokuroria akuzon të pandehurin në cilësinë e personit juridik “.... Shpk , për veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par. 1 lidhur me nenin 37 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074, dhe të pandehurin në cilësinë e personit përgjegjës, për veprën penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.

Kodi Penal i Kosovës me dispozitën e nenit 311 par.1 të saj, parasheh si në vijim: *Kushdo që duke kaluar vijën kufitare bartë mallra dhe shmang kontrollin doganor, ose kushdo që duke shmangur kontrollin doganor, kryen bartjen e mallrave dhe kalon vijën kufitare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.*

Nga dispozita ligjore si më lartë, del se vepra penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.1 mund të kryhet në dy mënyra: a) duke kaluar vijën kufitare bart mallra dhe shmang kontrollin doganor; b) duke shmangur kontrollin doganor, kryen bartjen e mallit dhe kalon vijën kufitare. Megjithatë në të dyja rastet, veprimet e kryerjes së veprës penale janë shmangia nga kontrolli doganor dhe kalimi i vijës kufitare si veprime kumulative, meqë nëse nuk ekziston njëri veprim, kjo formë e veprës penale nuk do të ekzistojë.

Bazuar edhe në Komentarin e Kodit Penal të Kosovës, *Shmangia e kontrollit doganor do të thotë fshëhja apo mos lajmërimi i mallit për kontroll - doganim ("shfere", kontrabandë), ndërsa me bartje nënkuptohet, kalimin e çfarëdo malli përtej vijës kufitare e cila është një vijë e menduar e cila e ndanë territorin e Republikës së Kosovës me vendet tjera të cilat e rrethojnë pa mbikëqyrjen doganore.*

Po sipas këtij Komentari, vepra penale, Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 par.1 i KPRK-së, *konsiderohet e kryer me ndërmarryjen veprimit për ta bartë mallin përtej kufirit duke iu shmang*

kontrollit doganor ose i shmangjet kontrollit doganor dhe bart mallin duke kaluar vijën kufitare për eksport. Bartja e mallit të kontrabanduar në mënyrë ilegale brenda apo jashtë vijës doganore, do të thotë kur në mënyrë të ndryshme futet malli ilegalisht përmes vendkalimeve zyrtare doganore me ç'rast malli nuk lajmërohet ose kur malli futet në territorin e Republikës së Kosovës jashtë vendkalimeve zyrtare në mënyrë ilegale, me qëllim që t'i shmangjet kontrollit të procedurave doganore.

Bazuar në gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, u tha edhe më lartë se është vërtetuar pa mëdyshje se malli i sekuestruar “Pëlhurë e endur –metrazhe” në sasi prej 49,474.00 kg, i gjetur tek i pandehuri në cilësinë e personit juridik “....”Shpk, nuk ka patur mbulesë dokumentare, mirëpo prokuroria nuk ka arritur që me asnjë provë të vërtetojë që kompania në fjalë, e pandehur në rastin konkret, duke kaluar vijën kufitare ka bart këtë mall dhe ka shmang kontrollin doganor ose duke shmangur kontrollin doganor, ka kryer bartjen e këtij malli dhe kalon vijën kufitare.

Prandaj në mungesë të provave fajësuese për të pandehurit, gjykata konfor nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, gjykata e liroi të pandehurin në cilësinë e personit juridik “.... Shpk, nga akuza për veprën penale, Kontrabandim i mallrave nga neni 311 par.1 lidhur me nenin 37 të KPRK-së dhe poashtu e liroi nga akuza edhe të pandehurin në cilësinë e personit përgjegjës, R.C, për veprën penale, Kontrabandim i mallrave nga neni 311 par.1 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konfor nenit 453 par.1 te KPP-së.

Bazuar ne te lartecukurat gjykata vendosi si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr. 297/22 datë 23.07.2024

Sekretarja Juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja ,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur mund të ushtroje ankesë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.